

VENDIM
Nr.656, datë 21.5.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA LAZARAT, TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Lazarat, të qarkut të Gjirokastrës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 11 (njëmbëdhjetë), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Lazarat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULAR PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE

(Mbështetur në inventarizimin e pronave të veçanta të tipit: kullota, livadhe, shkëmbore etj.)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU Komuna: Lazarat										
Nr.	Numri sipas inventarit	Emërtesa e ekonomisë pyjore dhe kullimore (EPK)	Emërtesa e ngastrës, vendndodhja (sipas emërteses popullore)	Numri i ngastrës	Destinacioni	Sipërfaqja në ha	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi të administrative	Institucioni, enti përdoues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	46	EP Mali Gjere	Pllashnja	31	P.Prodhues	39.8	Dru zjarri	MMPAU	Komuna	
2	47	"	Perroi i Cafos Kordhece	33/a	Bosh	4.0	Bosh	"	"	
3	48	"	Përroi i Cafos	b	Bosh	2.5	Bosh	"	"	
4	49	"	Përroi i Cafos	c	Bosh	4.5	Bosh	"	"	
5	50	"	Kodra e Dracit	d	Bosh	0.5	Bosh	"	"	
6	51	"	Kodra e Dracit	e	Bosh	1.25	Bosh	"	"	
7	52	"	Kodra e Dracit	f	Bosh	4.25	Bosh	"	"	
8	53	"	Lehnjas	g	Bosh	10.75	Bosh	"	"	
9	54	"	Lehnjas	h	Bosh	14.5	Bosh	"	"	
10	55	"	Pylli i Gjorkanes	34	P.Prodhues	37.7	Dru zjarri	"	"	
11	56	"	Pylli i Gjorkanes	35	P.Prodhues	2.0	Dru zjarri	"	"	

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
46 - 56	Pyll + Sip. të tjera	Në pronësi